

Për **Pagë me Jetu!** PSD propozon që:

- Paga minimale në Kosovë të rritet ashtu që t'i plotësoj nevojat e njeriut **me jetu**.
- Të drejtën në pagë minimale duhet ta ketë secili qytetar nga mosha 18 vjeçare.
- Të luftohet diskriminimi gjinor dhe pjesëmarrja e ulët e gruas në fuqinë punëtore.
- Të inkurajohet organizimi me qëllim që të rritet ndikimi i punëtorëve në dialogun shoqëror.
- Të përcaktohen kriteret e mirëqenies për përllogaritjen e pagës minimale në Kosovë.
- Të sigurohen të dhëna të besueshme për llogaritjen e indikatorëve socio-ekonomik që shërbejnë për caktimin e pages minimale.
- Të krijohen mekanizma për implementimin e pagës minimale.
- Te harmonizohet legjislacioni i Kosovës me parimet e ILO-s.

## KONTEKSTI

Paga minimale në Kosovë është më e ulëta në rajon. Ajo aktualisht është 170 euro për të punësuarit mbi moshën 35 vjeçare dhe 130 euro për ata nën këtë moshë. Kjo pagë nuk e mbulon as për së afërmi minimumin e nevojshëm për jetë. Paga minimale aktuale i lë punëtorët nën pragun e varfërisë.

Në anën tjetër, sipas ASK, Produkt i Brendshëm Bruto është rritur vitin e kaluar me 3.4%, pra kemi rritje të aktivitetit ekonomik, transaksione e akumulim. Ndërsa, paga minimale ka mbetur e njejtë. Sipas Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve që nxjerret nga ASK, shkalla mesatare e inflacionit në vitin 2018 ishte 1.1%, kurse, inflacioni vjetor, i matur në muajt dhjetor 2017 dhe dhjetor 2018 është 2.9%. Nga kjo shihet se përballë shkallës së inflacionit, fuqia blerëse ka rënë, pra edhe paga minimale është ulur. Vec kësaj, përgjatë periudhës 2011-2018, pagat në sektorin publik janë rritur 3 herë. Punëtorët që paguhen me nivelin e pagës minimale, që kryesisht janë të harruar nga shoqëria dhe shteti. Shumica prej tyre i përkasin sektorit privat dhe përfshijnë sektorë si punëtorët e sigurimeve private, ata të qendrave tregtare, pastrimit, rrobaqepësisë, shërbyesit shtëpiakë etj.

Mungesa e statistikave relevante për ekonomitë familjare e bën të pamundur matjen e ndikimit që mund të ketë rritja e pagës minimale, apo dëmin që e ka shkaktuar ngecja e saj.

Ta zëmë, gjatë vitit 2017 gjysma e ekonomive familjare kanë deklaruar se nuk kanë arritur ta mbulojnë një shpenzim të papritur prej 500 eurosh. Kjo statistikë pa dyshim se flet për gjendje të rëndë ekonomike. Nga kjo kuptohet që mundësite ekonomike të një pjesë të madhe të popullsisë janë të kufizuara tek konsumi bazik, nga muaji në muaj. Pra, të ardhurat e disponueshme për familje janë nën minimumin jetësor. Por, nga kjo shifër, për shkak të mungesës së të dhënave, vështirë ta kuptojmë se sa prej tyre janë të papunë, sa paguhen me pagë minimale etj.

Rritja e pagës minimale, duke qene se është ndërhyrje tek shtresa e punëtorëve që nuk ia dalin ta kapërcejnë muajin, do të rriste konsumin, pra do ta shtonte kërkesën agregate në ekonomi.

## **GRUAJA NË KOSOVË ËSHTË E PËRJASHTUAR NGA JETA SHQOËRORE EKONOMIKE**

Struktura e të punësuarve në Kosovë është në shpërputhje të plotë me balancin gjinor, sa i përket bazës materiale. Përveç faktit që Kosova ka trashëguar një sistem të caktuar të punësimit dhe kulturës, ku burrat kanë qenë kryefamiljarë, në një papunësi të thellë, siç është rasti me Kosovën, kryefamiljari ka qenë i punësuar eventual.

Ky shtresëzim është thelluar më tej. 80,7% të grave në Kosovë nuk janë duke kërkuar fare punë, për shkak të gjasave të vogla për t'u punësuar. Përderisa në sektorin publik piramida e punësimit dallon pak ca nga sektori privat, psh. tek administrata dhe arsimi, përsëri, punët me pagesë të ulët shumë shpesh i kryejnë gratë. Ndërsa gratë e punësuar në sektorin privat kryesisht gjenden në dyqane të ndryshme ushqimore, butiqe, farmaci, rrobaqepsi, etj., ku paga është shumë e ulët, e shumë shpesh gratë punojnë pa kontrata, ose me kontrata të përkohshme.

Duke qenë në pozitë të veshtirë ekonomike, me pagë të ulët dhe me kontratë të përkohshme, gratë nuk janë të lira dhe në këtë mënyrë po u cenohen të drejtat elementare të njeriut. Realisht, gratë në Kosovë janë të përjashtura nga jeta ekonomike. Në këtë mënyrë ato janë të përjashtuara (joformalisht) nga jeta publike dhe politike. Duke i lënë në varësi të ekonomisë familjare që zotërohet

prej burrit, sistemi ekonomik po e riprodhon represion mbi baza gjinore.

## **PAGA MINIMALE** - *instrument për reduktimin e pabarazisë*

Paga minimale ka për qëllim caktimin e dyshemesë ose pragut nën të cilën asnjë punëtor nuk mund të paguhet ligjërisht. Paga minimale është instrumenti që përdoret në dy drejtime: ajo shërben për reduktimin e pabarazisë midis punëdhënësit e punëmarrësit, por edhe si mekanizëm për luftimin e varfërisë.

Mbi 90 përqind e vendeve të botës e përdorin pagën minimale si instrument, megjithëse konceptimi, metodologjia e shkalla e saj ndryshojnë.

Është dëshmuar botërisht që paga minimale ka shumë efekte pozitive: rritja e saj e ulë pabarazinë në të ardhura dhe e rritë mirëqenien e gjithëmbarshme. Paga minimale është komponentë thelbësore e sistemit të mbrojtjes sociale të një vendi që ka për qëllim ta reduktojë varfërinë dhe ta risë drejtësinë shoqërore.

Në shumë vende është dëshmuar që paga minimale ka qenë efektive, mes tjerash, në reduktimin e pabarazisë në të ardhura, uljes e shpenzimeve buxhetore në skemat e mbrojtjes sociale, dhe në rritjen kohezionit shoqëror.

Paga minimale nuk mund të jetë kurrësi një politikë e vetmuar. Përmirësimi i gjendjes së punëtorëve duhet të shkojë krahas për krahas me politikën e punësimit. Për të pasur një ekonomi të integruar, duhet përpjekur që politikën për vendet e reja të punës (pra rritja e ofertës në ekonomi) t'i orientojmë drejt sektorëve prodhues. Kjo sepse kështu rritja e konsumit do të përkthehej në përmirësim të bilancit tregtar dhe ulje të importit.

## **METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIT TË PAGËS MINIMALE**

Megjithëse në nivel ndërkombëtar nuk ka një formulë të pagës minimale për të cilën pajtohen të gjitha shtetet, indikatorët e kriteret që merr parasysh pothuajse secili shtet mund të ndahen në dy lloje kriteresh. Grupin e parë do ta quajmë “kriteret e mirëqenies”, kurse të dytin, kriteret e “ekonomisë dhe biznesit”.

Praktikat për caktimin e pagës minimale janë të ndryshme, e këto ndryshime pasqyrojnë nivelet e ndryshme të zhvillimit shoqëror e politik. Ka vende ku ajo caktohet arbitrarisht prej shtetit, e këto vende janë zakonisht me nivel të ulët të organizimit sindikal; ka vende ku paga minimale është brenda-rajonale e sektoriale; në disa vende nuk ekziston si praktike e detyrueshme fare; megjithatë, praktika më e pranuar për caktimin e pagës minimale është ajo e dialogut social midis punëmarrësit, punëdhënësit dhe institucionit publik (shtetit).

Puna për caktimin e pagës minimale vendos dallimet e kontradiktat e sistemit, bashkë me aktorët respektivë në pozita negociuese. Kurse roli i shtetit është menduar të jetë arbitri i fundit që pajton e sintetizon interesat partikulare.

Ne besojmë se përcaktimi i pagës minimale duhet të burojë nga një proces gjithëpërfshirës demokratik në mes të partnerëve shoqëror.

Metodologjia për llogaritjen e pagës minimale në vend është gjëja më e rëndësishme në këtë diskutim. Nuk mund të flasim për nivelin e pagës minimale duke mos pasur mundësi ta analizojmë shkencërisht rolin e saj në shoqëri.

“Neni 86 i Ligjit të Punës i përcakton faktorët të cilët duhet të merren parasysh gjatë përcaktimit të pagës minimale:

- 4.1. kostoja minimale e shpenzimeve jetësore;*
- 4.2. përqindja e shkallës së papunësisë;*

- 4.3. gjendja e përgjithshme në tregun e punës;
- 4.4. shkalla e konkurrencës dhe produktivitetit në vend;
- 4.5. niveli i përgjithshëm i pagave në Republikën e Kosovës.”

Në mënyrë që kriteret të cilët e përcaktojnë pagën minimale t'i reflektojnë nevojat e punëtorëve dhe familjeve të tyre, ne duhet të marrim si model praktikat e ILO-së të cilat për ta caktuar pagën minimale i shqyrtojnë këto elemente:

(a) nevojat e punëtorëve dhe familjeve të tyre, të marrë parasysh nivelin e përgjithshëm të pagave në vend, koston e jetesës, përfitimet nga sigurimet shoqërore dhe standardi relativ i jetesës i grupeve të tjera shoqërore;

(b) faktorët ekonomik, duke e përfshirë nevojën për zhvillim ekonomik, nivelet e produktivitetit dhe dëshira për të arritë dhe mbajtë një nivel të lartë të punësimit në vend;

Procesi i përcaktimit të metodologjisë për caktimin pagës minimale duhet nisur nga parimi që punëtorit dhe familjes së tij t'i sigurohet niveli i të ardhurave që i garanton ushqim të bollshëm dhe të shëndetshëm, hapësirë të mjaftueshme banimi, qasje të lehtë në shërbime shëndetësore, arsim cilësor dhe përfshirje në jetën kulturore. Theksi që ka vënë ILO mbi standardin e grupeve tjera shoqërore është po ashtu i rëndësishëm. Paga minimale nuk duhet ta lë këtë grup larg dhe mbrapa grupeve tjera. Duhet synuar që standardi jetësor që siguron paga minimale të mos dallojë nga ai i shtresës së mesme të shoqërisë.

Puna paraprake për sigurimin e të dhënave statistikore që e bëjnë të mundur projektimin e kësaj politike dhe evaluimin e efekteve të saj është e një rëndësie primare.

## **ZBATIMI I PAGËS MINIMALE**

Detyrimet ligjore të dala nga Dialogu Shoqëror, dhe Marrëveshja Kolektive përmes të cilave rregullohen marrëdhëniet e punës në Republikën e Kosovës nuk kanë gjetur zbatim.

Paga minimale në Kosovë është më e ulëta në rajon. Ajo aktualisht është 170 euro për të punësuarit mbi moshën 35 vjeçare dhe 130 euro për ata nën këtë moshë. Kjo pagë nuk e mbulon as për së afërmi minimumin e nevojshëm për jetë. Paga minimale aktuale i lë punëtorët nën pragun e varfërisë.

Në Kosovë nuk janë shfrytëzuar punëtorët thjeshtë duke vendosur kriteret e gabuara, apo përcaktuar me vlerë të ulët nivelin e pagës minimale. Karakteristikë e pagës minimale si instrument është fakti se ajo lehtë mund të vjetërohet, prandaj edhe e papërdorshme.

Në mënyrë që paga minimale të shërbejë si instrument efikas rishpërndarjeje dhe politikë për luftimin e varfërisë, ajo duhet të përditësohet rregullisht. Kjo sepse vlera e saj duhet ta reflektojë standardin jetësor të kohës kur punohet. Paga minimale në Kosovë nuk ka ndryshuar që nga viti 2011. Ky ndalim e ka bërë jo efektive pagën minimale si politikë të mirëqenies, përderisa ka sabotuar dialogun social.

## **FUQIZIMI I SINDIKATAVE**

Ne mendojmë që politikat për të drejtat e punëtorëve duhet të ndikohen më së shumti nga punëtorët të organizuar në sindikata. Punëtorët janë ata që e dinë më së miri manifestimin e shkeljes së të drejtave elementare të tyre.

Partia Socialdemokrate do t'i mbështesë kërkesat dhe bashkëpunojë me sindikatat e punëtorëve për t'u siguruar që

punëtorët të kenë rol vendimarrës kur vlerësohet mundi e djersa e tyre.

Cështja e marrëdhënieve të punës, përveç që është çështje e kalitjes dhe konsolidimit të lëvizjes sindikaliste, ajo lidhet po ashtu me raportin midis punëtorëve dhe të papunëve. Sa më i madh numri i të papunëve, më e vështirë bëhet gjendja e atyre që punojnë. Punëtorët dhe të papunët janë aleat të natyrshëm midis të cilëve duhet të ketë solidaritet dhe jo konkurrencë negative.

Ne mendojmë që shoqërinë duhet ta organizojmë në atë mënyrë që negociimin për të drejta, e rrjedhimisht më shumë fuqi për ta, duhet ta bëjnë vet punëtorët, ndërsa Institucionet e Republikës t'i krijojnë mekanizmat efikasë për respektimin e të drejtave të tyre.